



REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR
KORÇE

- Gj. Ad. Libonik
- Drij. Tel. Gjy. Publike ✓
08.07.2020

Korce ne date 01.07.2020



“NJOFTIM ME SHPALLJE PUBLIKE”

Drejtuar per afishim: Ne kendin e njoftimeve prane Njesise Administrative Libonik

Per shtetasen e paditur: Dorina Groballi, datelindja 05.06.1994, banuese fshati Libonik, Njesia Administrative Libonik, Bashkia Maliq.

Prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Korçe eshte duke u gjykuar çeshtja civile qe i’u perket paleve:

Padites/e: Guljan Hanelli

E paditur: Dorina Groballi

Objekti: Zgjidhje martese dhe rregullimin e pasojave

Referuar njoftimeve te derguara dhe pohimeve te pales paditese Juve ndodheshit jashte teritorrit te Republikes se Shqiperise.

Gjykata pasi ezauroi etapat procedurale per njoftimin Tuaj sipas neneve 129-133 te K.Pr.Civile, si me siper, vendosi te procedoje me njoftimin nepermjet shpalljes publike, bazuar ne nenet 133/a dhe 133/b, te K.Pr.Civile, duke u afishur nje kopje e shpalljes prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Korçe, si gjykata ku gjykohet mosmarreveshja, nje kopje prane Njesise Administrative Miras dhe nje kopje prane Njesise Administrative Libonik ku rezulton se ndodhet vendbanimi Juaj zyrtar, kopje ne deren e baneses se fundit te vendbanimit Tuaj zyrtar, si dhe ne faqen zyrtare te gjykates, per t’u njoftuar per padine, aktet shoqeruese dhe seancen pajtimore date 01.07.2020, ora 10:00

Seanca pergatitore/pajtimore date 01.07.2020 u zhvillua ne prezence te avokatit te pales paditese, i cili ne seancat date 28.02.2020 dhe 03.06.2020 ka qene prezent personalisht dhe ka deklaruar se nuk mund te arrihej pajtimi si dhe ne mungesen Tuaj si e paditur. Ne seancen pergatitore/pajtimore date 01.07.2020 u paraqit personalisht paditesi i cili deklaroi se nuk mund te arrihej pajtimin me Ju si pale e paditur.

Ne perfundim ne baze te nenit 135 te K.Familjes dhe te nenit 158/c te K.Pr.Civile Gjykata vendosi kalimin e ceshtjes ne séance gjyqesore ku do te administrohen si prova certifikata e martesës, certifikate familjare dhe dy certifikata personale.

Nepermjet ketij njoftimi Ju bejme me dije sa me siper dhe se me rifillimin e veprimtarise gjyqesore seanca gjyqesore eshte planifikuar te zhvillohet ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Korçe date 07.09.2020, ora 13.⁰⁰.

Mosparaqitja tuaj si e paditur, pa shkak, passjell zhvillimin e gjykimit ne mungese.

Kjo shpallje do te qendroje e afishuar ne vendet e mesiperme minimalisht 20 (njetzet dite) nga dita e neserme e afishimit.

Shpallja do t’iu dergohet ne dy kopje, njera prej te cilave te percillet ne Gjykate, menjehere pas afishimit

Nr. 90 Prot
dt. 08.07.2020

**GJYOTARE
SONJELA VOSKOPI**

Shpallja u afshua sot ne date.....



SHENIM: Per punonjesin e Njesise Administrative Libonik.

**Ju lutemi afshoheni shpalljen ne kendin e njoftimeve prane Njesise Administrative Libonik,
duke pasqyruar faktin e afshimit dhe daten e afshimit.**